



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:091725

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05724194

PKR.nr. 518/2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje nga gjyqtari Avni Sylja, kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionistë Alban Ajvazi dhe Sulltane Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Valbone Musa Lajçi, në çështjen penale kundër të pandehurve Xh.K dhe B.H, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.637-7/2012 të datës 22.02.2013, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur, me dt. 22.03.2024 me prezencën e Prokurores së shtetit Dulina Hamiti, të akuzuarit Xh.K me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. Haxhi Millaku dhe të akuzuarit B.H me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Ilir Gashi, me datë 26.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.Xh.K nga i ati I. dhe e ëma S.i lindur me dt..... në fshatin T.. e P., Komuna e M., me vendbanim në P. në lagjen "A." rruga "E." nr.50/42, i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, me gjendje të mesme ekonomike, me nr. personal 1..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.B.H nga i ati N. dhe ëma N. e gjinisë M, i lindur me dt... në fshatin N., Komuna e M., ku edhe ka vendbanimin në Rr. "B.", i pa martuar, ka të kryer fakultetin teknik, punëtor, me gjendje të dobët ekonomike, me nr. personal 1...., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I. I akuzuari Xh.K

LIROHET NGA AKUZA

Në vitin 2010 dhe 2011 në Prishtinë, sipas marrëveshjes paraprake e me qëllim që vetes ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm janë marrë me kontrabandim të migrantëve ashtu që i pandehuri Sh.K ka siguruar nga zyra e avokatëve dhe konsulencë “Cristophe&Associates” P.C nga Nju Jorku ftesën e datës 18.10.2010 adresuar në emër të H.K, Zëvendës Kryeministër i Republikës së Kosovës, për vizitën e tij zyrtare në SHBA dhe punëtorëve qeveritar, të pandehurin Xh.K, F.Gj dhe Q.V si dhe personin F.T, në bazë të së cilës ftesë i pandehuri Xh.K ka përpiluar kërkesë zyrtare për notë verbale me ç’ rast përveç emrit të vet dhe emrave të zyrtarëve F.Gj dhe Q.V ka përfshirë edhe emrin e personit D.T, edhe pse ka ditur se ky person nuk është punëtorë qeveritar, të cilën kërkesë e ka dorëzuar në Departamentin për Çështje Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) në bazë të së cilës kjo ministri ka lëshuar notë verbale numër 1000-1289/10 të datës 27.10.2010, ku pastaj i pandehuri Sh.K ka siguruar vizën zyrtare në ambasadën e SHBA-ve në Shkup, për personin F.T, i cili për këtë shërbim i ka paguar të pandehurit Sh.K shumën prej 15,000.00 euro dhe ka emigruar në SHBA ku dhe tani qëndron si dhe në vazhdimësi në vitin 2011 në Prishtinë i pandehuri Sh.K ka arritur të siguroj edhe një ftesë nga zyra e avokatëve dhe konsulencë “Christopher&Associates” P.C nga Nju Jorku adresuar në emër të H.K, Zëvendës Kryeministër i Republikës së Kosovës, për vizitën e tij zyrtare në Nju Jork dhe punëtorin qeveritar të pandehurin Xh.K si dhe personat A.R, D.M, M.G dhe N.T, të cilët nuk ishin punëtorë qeveritarë, në bazë të së cilës ftese i pandehuri Xh.K ka përpiluar kërkesë zyrtare për notë verbale dhe e ka dorëzuar në MPJ, e cila ministri sipas kërkesës ka lëshuar notë verbale numër 34-406/11 e datës 15.03.2011, ku pastaj i pandehuri Sh.K ka siguruar vizat zyrtare në ambasadën e SHBA-ve në Shkup për personat A.R, D.M, M.G dhe N.T, të cilët për këtë shërbim i kanë dhënë të pandehurit Sh.K shumën e panjohur të parave dhe kanë emigruar në SHBA ku edhe tani gjenden.

- **Sepse nuk është provuar se i akuzuari në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.**

II. I akuzuari B.H

LIROHET NGA AKUZA

Gjatë vitit 2010 në Prishtinë, sipas marrëveshjes paraprake e me qëllim që vetes ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm janë marrë me kontrabandim të migrantëve ashtu që i pandehuri Sh.K paraprakisht ka siguruar ftesë nga organizata amerikane “Carr” të datës 19.07.2010, për vizitë zyrtare në SHBA në krye me zëvendës ministrin e Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës (MTI) J.K dhe zyrtarit të kësaj ministrie N.R, të cilën ia ka dorëzuar personalisht të pandehurit J.K i cili, edhe pse e ka ditur se dy persona në ftesë dhe atë H.B dhe A.K nuk kanë qenë punëtor të asaj ministrie, ka kërkuar nga asistenti i tij i pandehuri B.H që ta procedoj për sigurimin e vizave zyrtare ku pastaj i pandehuri B.H e datë 21.07.2010 ka dërguar kërkesë zyrtare për lëshimin e notës verbale në Departamentin për Çështje Konsullore të ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës (MPJ) duke e inkorporuar edhe emrin e vet në këtë kërkesë, në bazë të së cilës kërkesë MPJ ka lëshuar notë verbale numër 614-786/10 të datës 21.07.2010

në emër të personave J.K, N.R, H.B dhe A.K, mirëpo duke parë se emri i të pandehurit B.H nuk është i përfshirë në notën verbale i pandehuri Sh.K në marrëveshje me të pandehurin B.H ka siguruar një ftesë tjetër nga organizata amerikane “Carr” të datës 12.08.2010, në të cilën ftesë kësaj radhe janë përfshirë emrat e zëvendës ministrit J.K. O.H dhe A.M, të cilën ftesë i pandehuri B.H e ka dërguar në MPJ me kërkesë zyrtare për lëshimin e notës verbale, duke i përfshirë në kërkesë edhe emrat e personave të cilët nuk ishin punëtor qeveritarë dhe atë: A.K, O.H dhe A.M, në bazë të së cilës kërkesë MPJ ka lëshuar notë verbale numër 614-786/10 të datës 16.08.2010, ku pastaj i pandehuri Sh.K ka arritur që të siguroj vizat zyrtare në ambasadën e SHBA-ve në Shkup, për personat e më lart cekur, të cilët për këtë shërbim i kanë paguar të pandehurit Sh.K shuma të panjohura të parave dhe kanë emigruar në SHBA ku edhe tani gjenden.

- **Sepse nuk është provuar se i akuzuari në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.**

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore, të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj Gjykate ka ushtruar aktakuzën PP.nr.637-7/2012 të dt. 22.02.2013, kundër të akuzuarve Sh.K dhe Xh.K për shkak të veprës penale në vazhdimësi në bashkëkryerje Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, të pandehurit Sh.K dhe B.H për shkak të veprës penale në vazhdimësi në bashkëkryerje Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, të pandehurit J. K. për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par 1 të KPK-së, të pandehurit Sh.K për shkak të veprës penale Falsifikim i parasë nga neni 302 par 2 të KPK-së, dhe veprës penale Kanosja nga neni 161 par 4 lidhur me par 1 të KPK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda me aktvendimin PKR.nr.518/14 të datës 01.10.2014 ka veçuar procedurën ndaj të akuzuarve Xh.K, B.H dhe J.K për arsye se i akuzuari Sh.K e ka pranuar fajësinë për veprat penale me të cilat e ka ngarkuar aktakuza dhe me aktgjykimin PRKR.nr.43/13 të datës 01.10.2014 të njëjtin e ka shpallur fajtor, ndërsa me aktvendimin PKR.nr.518/14 të datës 19.11.2015 e ka hudh aktakuzën dhe e ka pushuar procedurën penale sa i përket të akuzuarit J.K për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Gjykata në prani të këtyre rrethanave ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor vetëm sa i përket të akuzuarve Xh.K dhe B.H të cilët nuk e kanë pranuar fajësinë sa i përket veprave penale me të cilat i ngarkon aktakuza dhe brenda afatit të paraparë ligjor të akuzuarit kanë paraqitur kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave për të cilat kërkesa gjykata me aktvendimin PKR.nr.518/2014 të datës 01.06.2020 i ka refuzuar, të cilin vendim e ka vërtetuar Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin PN.nr.535/20 të datës 12.08.2020.

Në prani të këtyre rrethanave gjykata ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor ku është dhënë fjala hyrëse e palëve, është dëgjuar dëshmitari M.M, ndërsa është refuzuar propozimi i prokurorisë për dëgjimin e dëshmitarit M.M pasi që i njëjti ka qenë i dyshuar në procedurë të përbashkët me të akuzuarit e tjerë, po ashtu trupi gjykues sa i përket dëshmitarit L.K i cili ka qenë i propozuar në aktakuzë nga prokuroria por që dëshmia e tij ka pasur të bëjë vetëm sa i përket pikës V të dispozitivit të aktakuzës por që për këtë pikë gjykata ka vendosur me aktgjykim sa i përket të akuzuarit Sh.K, si dhe sa i përket dëshmitarit N.R gjykata ka vërtetuar nga kopja e certifikatës së vdekjes 19/2021 RV/19001 se i njëjti ka vdekur me datë 11.01.2021, dhe se për te njëjtin gjykata me propozimin e prokurorit ka vendos që të lexohet deklarata e dhënë në polici me datë 03.10.2012, gjithashtu për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, është bërë administrimi i provave, është dhënë mbrojtja e të akuzuarve si dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i Shtetit, ne seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 22.03.2024 ka deklaruar se, nga administrimi i provave dhe dëshmive në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të plotë është vërtetuar se të akuzuarit Xh.K me të gjykuarin Sh.K kanë kryer veprën penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, si dhe është vërtetuar në mënyrë të plotë se i akuzuari B.H në bashkëkryerje me të gjykuarin Sh.K ka kryer veprën penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, kjo gjendje si në dispozitivin I dhe II të aktakuzës është vërtetuar edhe nga administrimi i provave materiale siç janë përshkruar në aktakuzë, pra me administrimin e gjitha këtyre provave dhe dëshmive është vërtetuar se të akuzuarit Xh.K dhe B.H kanë kryer veprat penale si në aktakuzë dhe i propozoj gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të merret parasysh edhe pesha e rëndë e këtyre veprave penale, mënyra dhe rrethanat e kryerjes.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.K av. Haxhi Millaku në fjalën përfundimtare deklaroi se: Bazuar në fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit sipas aktakuzës PP.nr.637-7/2012 të datës 22.02.2013 për pikën I të aktakuzës që i vë në barrë të mbrojturim tim Xh.K në bashkëkryerje me të dënuarin Sh.K i cili ka pranuar fajësinë dhe është gjykuar para disa viteve, prokurori i shtetit jo vetëm gjatë fazës së hetimeve por as sot në fjalën përfundimtare nuk prezantoi asnjë nga provat qoftë personale apo materiale edhe pse thirret se Xh.K sipas përshkrimit faktik ka përpiluar kërkesë zyrtare për notën verbale dhe e ka dorëzuar në ministrinë e punëve të jashtme, në asnjë provë, shkresë, akt, kërkesë apo aprovim të kësaj note verbale nuk figuron nënshkrimi emri apo firma e tij dhe sigurisht se nuk ka pasur as autorizim mbi bazën e vendit të punës sepse në kohën kritike Xh.K ka qenë në cilësinë e shoferit dhe nuk kam parë asnjë shkresë të lëndës qoftë autorizim që nga ministria e Punëve të Jashtme apo ndonjë person zyrtar ti ketë dhënë autoritet apo leje për ndonjë veprim të kësaj natyre, për më tepër asnjë dëshmitar me asnjë dëshmi apo provë e cila u administrua në gjykatë nuk figuron që të ketë vepruar Xh.K lidhur me këto veprime. Ka theksuar se e njoftojmë gjykatën se vet Xh.K personalisht ka pasur vizë në pasaportë dhe nuk e ka shfrytëzuar në atë kohë që nënkupton se nuk ka pas interesim, andaj i propozoj

gjykatës që në mungesë të provave personale dhe materiale të njëjtin ta liroj nga akuza në kuptim të nenit 363 par 1 pika 1.3.

I akuzuari Xh.K në fjalën përfundimtare deklaroi: E përkrahi fjalën përfundimtare të mbrojtësit duke shtuar se gjatë procesit gjyqësor në këtë çështje penale asnjëri nga dëshmitarët nuk më ka përfshirë të jem pjesë e kësaj veprë penale dhe siguroi se nuk ka të bëjë asgjë në lidhje me këtë që më ngarkon akuza pasi që as sot nuk kam dijeni ta përdori e-mailin, andaj mbi këtë bazë kërkoi nga gjykata të më liroi nga aktakuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.H av. Ilir Gashi fjalën përfundimtare ka dorëzuar me shkrim në të cilën ka theksuar se: Aktakuza e ngritur kundër të mbrojturit tim nuk i plotëson as kushtet elementare në lidhje me veprën penale për të cilën ngarkohet si nga përshtkrimi faktik ashtu edhe juridik, për të ekzistuar një veprë e tillë penale duhet plotësuar disa kushte elementare mbi të gjitha fillimisht duhet të ekzistojë vullneti i plotë dhe dashja. Tutje ka theksuar se prokuroria është thirrur se klienti im në bashkëkryerje me ish të bashkakuzuarin Sh.K kanë pasur përfitime materiale nga veprat penale për të cilën dyshohet mirëpo deri më tani përveç se nuk është provuar se i mbrojturi im të ketë kryer këtë veprë penale me asnjë provë të vetme kjo prokurori nuk ka arritur të e dëshmoj provoj se i mbrojturi im të ketë pasur ndonjë përfitim apo dobi materiale nga asnjë person, qoftë edhe nga të bashkakuzuarit tjerë apo ndonjë palë e tretë të përfshirë në këtë rast. Ka shtuar se nga përshtkrimet në aktakuzë dhe shkresat e lëndës i vetmi person i cili ka pasur përfitime pasurore të kundërligjshme në këtë rast është Sh.K dhe se i njëjti me veprimet e tij përveç që ka vënë në lajthim tani të akuzuarit e tjerë duke përfshirë edhe zëvendës ministrin i njëjti ka vënë në lajthim edhe ministrinë si organ qeveritar nga i cili janë lëshuar dokumente. Nga vet aktakuza kuptohet se i mbrojturi im nuk ka ndërmarrë asnjë veprim inkriminues të kësaj veprë për faktin se i njëjti gjatë kohës kur pretendohet se është kryer kjo veprë penale ka qenë në cilësinë e asistentit të zëvendësministrit J.K dhe mbi bazën e kësaj kuptohet se i njëjti ka vepruar në bazë të udhëzimeve të mbikëqyrësit e në këtë rast të zëvendësministrit. Në fund ka shtuar se i mbrojturi im është tërësisht i pafajshëm për veprën penale që i vihet në barë nga prokuroria pasi që prokuroria nuk ka arritur me asnjë provë materiale apo personale ta mbështes aktakuzën andaj i ka propozuar gjykatës që të mbrojturin e tij B.H ta liroj nga akuza dhe ta hudhë aktakuzën si të pabazuar pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari B.H në fjalën përfundimtare deklaroi se: E përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim duke shtuar se për 12 vite rresht unë jam ngarkuar me aktakuzë pa drejtësisht pasi që asnjëherë nuk jam përfshirë në vepra të tilla siç më ngarkon aktakuza dhe në këtë rast kam mundë të jem pre e mashtrimit por asnjëherë nuk kam pasur të bëjë me këtë veprë andaj kërkoi nga gjykata që të më liroj nga akuza në lidhje me këtë veprë penale.

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve si dhe ato në favor të tyre duke iu mundësuar të akuzuarve shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga

një dhe në lidhje me provat tjera, gjithashtu gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim nenit 360 të KPPRK-së, ka analizuar edhe deklaratat e të dëshmitarëve dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Procedura e Provave

Dëshmitari M.Mj në seancën dëgjimore të datës 26.01.2024, ka deklaruar se: Gjatë periudhës 2010-2011 kamë qenë në Llukë të Ulët, F.T është vëllai im i njëjti gjendet në Amerikë nga viti 2010 dhe nuk kam njohuri se si ka shkuar, pasi që i njëjti nuk ka pas marrëdhënie të mira familjare dhe nuk ka jap sqarime dhe në atë periudhë nuk ka punuar askund, ndërsa personin me emër Xh.K dhe B.H nuk i kam njohur kurrë e as nuk i njoh.

Për dëshmitarin N.R gjykata me propozimin e prokurorit ka bërë leximin e deklaratës së dhënë në polici me datë 03.10.2012, pasi qe siç u theksua më lartë i njëjti ka ndërruar jetë. Në polici ka deklaruar se ne lidhje me Notën Verbale për Viza në SHBA, me kujtohet se kemi pas një ofertë për vizitë zyrtare në SHBA dhe janë bërë të gjitha procedurat e nevojshme për të marr vizat të cilat procedura i kanë kryer stafi teknik dhe nuk është marr me to niveli i lartë. Ka theksuar se e njëjti Sh.K dhe për herë të parë e kam takuar në Ministri kur ka ardh dhe me të me ka njoftuar zv. Ministri J.K, dhe te njëjtin e prezantoj si nxënësin e tij dhe tha se është punëtor i Ambasadës në Shkup, e gjithashtu me tha se kemi me pas një vizitë zyrtare në SHBA. Ka shtuar se Sh.in e ka takuar diku një apo dy here për herën e fundit e kam takuar diku dy – tri javë para se të arrestohej e kom thirre në telefon duke menduar se punon në Ambasadën e SHBA-se, pasi qe unë kisha apliku për punë në një pozitë dhe doja ta përdorja Sh.in si referencë, dhe ky ishte një takim i shkurt dhe me tha do shiqoj. Ka shtuar se sa i përket vizitës së tij në Ministri mund te them se e kam pa me B.n por unë nuk kam pasur kontakte me të. Ka theksuar se nuk kam marr pjesë në përpilimin e notës verbale, ndërsa në pyetjen se kush e ka përpiluar notën verbale ka theksuar se besoj qe B.. Ka shtuar se nuk e ka parë kërkesën para se të procedohet më tutje. Në pyetjen se kush e ka kërkuar pasaportën tuaj për ta marr vizën, ka theksuar se nuk më kujtohet saktë ky detaj por me siguri ose B.t ose zv. Ministrit ja kam dorëzuar pasaportën. Ka shtuar se zv. Ministri me patë thënë se kjo vizitë do të jetë zyrtare dhe i atribuohet promovimit te investimeve ne Kosovë.

Gjykata duke pas parasysh të lartcekurat pasi që nuk patë dëshmitarë të tjerë për të dëgjuar lidhur me këtë çështje penale administroi edhe provat materiale siç janë: Ftesa e organizatës amerikane “Carr” e dt.19.07.2010, kërkesa për notë verbale e datës 21.07.2010 e përpiluar nga i pandehuri B.H, ftesa e organizatës amerikane “Carr” e datës 12.08.2010, kërkesa për notë verbale e datës 19.08.2010 e përpiluar nga i pandehuri B.H, komunikimi përmes e-mailit zyrtar në mes të B. Hoxhës e J.B e dt.21.07.2010 dhe dt.16.08.2010, 2 (dy) notat verbale me nr. protokolli të njëjtë 614-786/10, njëra e dt.21.07.2010 e tjetra e dt.16.08.2010 të lëshuara nga Ministria e Punëve të Jashtme që i referohen Ministrisë së tregtisë dhe industrisë, nota verbale me nr. protokolli 1000-1289/10 e dt. 27.10.2010 e lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme që i referohet zyrës zëvendës Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ftesa e zyrës së avokatëve dhe konsulencë “Cristophe & Associates” PC nga Nju Jorku, “Cristophe & Associates” PC, që

mbajnë emrin dhe fotografinë e vizitorit në këtë rast të pandehurit Sh.K, njëra e datës 10.06.2010 e tjetra e dt.03.01.2012, raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë nr. AKF/2012-3286/1167 e dt.14.12.2012.

Mbrojtja e të akuzuarve

Të akuzuarit Xh.K dhe B.H në shqyrtimin gjyqësor të dt. 07.03.2024 kanë deklaruar se pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tyre ligjore dhe konsultimit të mjaftueshëm edhe me mbrojtësit e tyre e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre që të mbrohen në heshtje.

Gjetjet e gjykatës

Nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese në dispozitivin I dhe II të aktakuzës si dhe nga administrimi i provave personale dhe materiale në shqyrtim gjyqësor, nuk rezulton se në veprimet e të akuzuarve formësohen elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, e që përbëjnë figurën e veprës penale, në bashkëkryerje Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Për tu konsideruar se kemi të bëjmë me vepër penale ajo vepër duhet të përcaktohet me ligj dhe duhet të përcaktohen elementet e veprës penale, e që nga të gjitha këto rrjedhë qartë se kualifikimi sipas aktakuzës që është objekt i shqyrtimit nuk e mbështet dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit me veprimet e tyre kanë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohen, pasi që provat nuk e ndërlidhin përshkrimin faktik të aktakuzës dhe dyshimin e bazuar mirë për të krijuar bindjen që veprat penale kanë ndodh dhe se të akuzuarit janë kryesit e tyre.

Prokuroria në dispozitivin I të aktakuzës të pandehurin Xh.K e ka ngarkuar se gjatë vitit 2010 dhe 2011 në bashkëkryerje dhe pas një marrëveshje paraprake me të pandehurin Sh.K e me qëllim të përfitimit pasuror janë marrë me kontrabandim të migrantëve dhe i pandehuri Xh.K ka përpiluar kërkesa zyrtare për notë verbale të cilën e ka dorëzuar në MPJ. Një përshkrim i tillë nga ana e prokurorisë për gjykatën ka qenë shumë i paqartë për faktin se nga provat personale dhe materiale gjykata nuk ka vërtetuar një fakt të tillë, notat verbale të cilat janë të bashkëngjitura në shkresat e lëndës nuk janë të nënshkuara dhe nuk dihet se nga kush janë përpiluar këto nota verbale konkretisht nga i akuzuari Xh.K, i cili ka deklaruar se ne ketë ministri ka pasur pozitë të shoferit dhe nuk ka ditë as ta përdor kompjuterin dhe nga ky pozicion është e palogjikshme që i njëjti të kryej veprime të tilla siç e ngarkon aktakuza apo së paku të vërtetohet me ndonjë provë se i njëjti ka përpiluar një dokument të tillë. Për më tepër edhe nga dëshmia e dëshmitarit M.Mj i cili është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor i njëjti kur është pyetur në lidhje me dy të akuzuarit Xh.K dhe B.H i njëjti ka deklaruar se nuk i kam njohur kurrë e as nuk i njoh asnjërin. Gjithashtu as dëshmitari N.R në deklaratën e dhënë në polici me datë 03.10.2012, ka deklaruar se në lidhje me Notën Verbale për Viza në SHBA, me kujtohet se kemi pas një ofertë për vizitë zyrtare në SHBA dhe janë bërë të gjitha procedurat e nevojshme për të marr vizat të cilat procedura i kanë kryer stafi teknik dhe nuk është marr me to niveli i lartë, por që në asnjë rrethanë nuk ka përmend se notën verbale e ka përpiluar Xh.K ashtu siç e ngarkon prokuroria.

Po ashtu prokuroria në dispozitivin II të aktakuzës të pandehurin B.H e ka ngarkuar se pas një marrëveshje paraprake gjatë vitit 2010 në Prishtinë me qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm në bashkëkryerje me të pandehurin Sh.K janë marrë me kontrabandim të migrantëve ku i pandehuri B.H me datë 21.07.2010 ka dërguar kërkesë zyrtare për lëshimin e notës verbale në Departamentin për Çështje Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, e pas një marrëveshje me të pandehurin Sh.K ku ky i fundit ka siguruar një ftesë tjetër nga organizata “Carr” të datës 12.08.2010 ku e ka përfshirë edhe emrin e të pandehurit B.H të cilën kërkesë i pandehuri B.H e ka dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme, por që gjykata nga provat personale dhe materiale nuk ka mundur të vërtetoj një pretendim të tillë të prokurorisë. Nga përshkrimi i dispozitivit si në pikën II të aktakuzës prokurorisë i është mjaftuar te theksohet fakti se së bashku me të akuzuarin Sh.K i akuzuari B. ka bërë kërkesë në MPJ për lëshimin e notës verbale për personat e lartcekur, por që me asnjë provë nuk ka arrite të bindë gjykatën se cilat ishin veprimet inkriminuese të të akuzuarit B.H në drejtim të veprës penale Kontrabandim me migrant siç ngarkohet me pikën II të dispozitivit të aktakuzës të vërtetoi se cili ishte mandati i tij dhe a kishte mundësi e kompetencë bazuar në përshkrimin e vendit të punës që ka bërë në ministri konkretisht nga pozita e asistentit të bëjë kërkesë për notë verbale në MPJ dhe te ju mundësoi personave të lartcekur që te pajisen me viza për në SHBA, këtë fakt prokuroria nuk ka mund të bind gjykatën, andaj edhe në mungesë të kësaj ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e njëkohshme e të gjithë elementeve përbërës të saj, elementeve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale e që shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjitha elementeve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer dhe kryesi i saj mbanë përgjegjësi penale kur ekzistojnë në tërësi elementët e saj. Nëse mungon njëri prej këtyre elementeve, vepra penale nuk ekziston.

Vepra penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par 1 lidhur me nenin 31 të KPKR-së shprehimisht përcakton *“Kushdo që merret me kontrabandim të migrantëve dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri dhjetë (10) vjet”* ndërsa shprehja *“kontrabandim me migrantë”* nënkupton *çdo veprim me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti.*

Gjykata ka ardhur në përfundimin, se akuza e ngritur kundër të akuzuarve nuk është e bazuar në prova të mjaftueshme, pasi që prokuroria ka dështuar të paraqes prova të mjaftueshme dhe të besueshme për ta vërtetuar fajësinë e tyre, përkatësisht prokurori i shtetit, me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk ka arritur ta vërtetoj në mënyrë të padyshimtë se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen. Në rastin konkret nuk kemi asnjë provë materiale apo personale e cila do të vërtetonte se të akuzuarit kanë kontrabanduar me migrantë pasi që edhe dëshmitari i vetëm i dëgjuar në këtë çështje penale juridike nuk arriti të vërtetoi

ndonjë fakt lidhur me provat e prezantuara nga prokuroria, veprimet faktike të të akuzuarve nuk i përkasin një kualifikimi të tillë dhe nuk ndërlidhen me asnjë provë konkrete, që rrjedhë se në rastin konkret sipas vlerësimit të gjykatës në asnjë mënyrë nuk konsumohen elementet e veprës penale si në aktakuzë.

Gjykata analizoi edhe provat materiale të propozuara nga prokuroria por që nga ta njëjtat gjykata nuk mundi të vërtetoj ndonjë fakt me rëndësi pasi që notat verbale në të cilat thirret prokuroria të njëjtat janë të përpiluara në gjuhën angleze të pa nënshkuara e të cilat shihet se i janë drejtuar ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shkup.

Kërkesa për notë verbale e datës 21.07.2010 të cilës kërkesë i është bashkëngjitur edhe ftesa e dërguar nga kompania “Carr” e cila është në gjuhën angleze, e cila kërkesë i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme për një vizitë ku të ftuar kanë qenë zëvendës Ministri i MTI-së J.K, N.R, H.B, A.K dhe B.H, por që e njëjta nuk është e nënshkruar nga askush.

Nga e-mailat zyrtar të datës 21.07.2010 shihet se ketë email e ka dërguar B.H tek J.B ku thuhet se bashkëngjitur gjeni kërkesën për notë verbale, por që prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme siç u theksua më lartë se përpiluesi i kësaj note verbale a ishte B.H dhe a ishte personi zyrtar kompetent për ti përpiluar këto kërkesa, apo të njëjta vetëm se i kishte përcjell në MPJ, sipas detyrave që ka marrë nga vartësit e tij, pasi siç dihet i njëjti në ministri ka punuar në cilësi të asistentit, andaj për një provë e tillë për gjykatën nuk ishte e mjaftueshme për të vërtetuar faktin se i akuzuari B.H ishte personi kompetent dhe përpiluesi i kësaj kërkesë.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit të vetëm të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje juridike penale M.Mj i cili ka deklaruar se të pandehurit Xh.K dhe B.H nuk i ka njohur kurrë e as nuk i njeh.

Po ashtu edhe sa i përket dëshmisë së dëshmitarit N.R i cili në dëshminë sa i përket të akuzuarit Xh.K askund nuk e përmend emrin e tij, ndërsa sa i përket të akuzuarit B.H i njëjti ka shpjeguar se si e ka njohur Sh.K përmes zv.Ministrit J.K, por që sa i përket të akuzuarit B. ka theksuar se nuk kam pasur kontakte me të, gjithashtu ka shtuar se nuk ka marr pjesë në përpilimin e notës verbale por që kur është pyetur se kush e ka përpiluar notën verbale ka theksuar se besoj që B., që do të thotë se përgjigja e tij ka qenë e pasigurt dhe me hamendje, në bazë të deklaramit të tij. Nga dëshmia e këtyre dy dëshmitarëve të lartcekur njëri i dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor dhe dëshmitarit N. të cilit i është lexuar deklarata në polici, gjykata nuk ka arrit të vërtetoj se plotësohen elementet e veprës penale siç ngarkohen te akuzuarit në pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës.

Siç u theksua më lartë Prokuroria në cilësi të dëshmitarit kishte propozuar që të dëgjohet edhe M.M e që është bërë për të njëjtin një gabim teknik në aktakuzë ku figuron emri M. por që gjykata nga shkresat e lëndës ka vërtetuar se ndaj të njëjtit ekziston Aktvendimi për fillim të hetimit PP.nr.637-7/2012 të dt. 30.08.2012, andaj duke u bazuar edhe në dispozitat e nenit 123 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së i cili është në fuqi e cila dispozitë në mënyrë specifike përcakton se si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje i bashkëpandehuri derisa procedura zbatohet e

përbashkët apo e veçuar përveç kur i njëjti është dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 234 të KPPRK-së, andaj duke u bazuar në të gjitha këto gjykata ka refuzuar kërkesën e prokurorit që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet M.M.

Pohimi i Prokurorisë se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale si në aktakuzë ishte vetëm një dyshim i cili nuk ka mbështetje në asnjë provë të besueshme – relevante, pasi që bashkëkryerja ekziston “kur dy apo më shumë persona duke marr pjesë në veprimin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër së bashku kryejnë veprën penale,”. Për të ekzistuar kjo formë e bashkëpunimit duhet të plotësohen elementi objektiv, pra si bashkëkryerës është personi i cili së bashku me të tjerët ndërmerr veprimin e kryerjes së veprës penale të caktuar si dhe elementi subjektiv pra si bashkëkryerës është personi i cili së bashku me tjetrin në bazë të marrëveshjes mbi ndarjen e punës realizon pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale, e ka dëshiruar pasojën dhe veprën penale e konsideron si të veten. Në rastin konkret gjykata duke e analizuar dispozitivin I dhe II të aktakuzës dhe arsyetimin e saj dhe duke i ndërlidhur me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor si dhe në deklaratën e dëshmitarit gjen se nuk ekziston bashkëkryerja në veprimet e të akuzuarve për të kryer veprën penale si në aktakuzë, pasi që nuk është vërtetuar me asnjë provë lidhja e caktuar objektive dhe subjektive, fakti se i akuzuari Sh.K e ka pranuar fajësinë dhe është dënuar nga gjykata nuk nënkupton se i njëjti është marrë vesh me të pandehurit Xh.K dhe B.H për të kryer veprën penale për të cilën akuzohen, sepse nuk është provuar me asnjë provë se të njëjtit në bazë të ndonjë marrëveshje mbi ndarjen e punës i kanë ndarë punët dhe kanë realizuar pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale si dhe e kanë dëshiruar pasojën, e gjithashtu me asnjë provë nuk është vërtetuar as fakti se të njëjtit kanë përfituar ndonjë dobi financiare apo pasurore.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPRK-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “in peius” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (beyond reasonable doubt) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “in favorem” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet, andaj edhe ka vendosur që të akuzuarit ti lirojë nga akuza konform dispozitës se nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale Gjykata me datë 26.03.2024 ka bërë shpalljen e aktgjykimit, por duke pasur parasysh kompleksitetin e kësaj çështje penale si dhe volum të madh me lëndë tjera Kryetari i trupit gjykues ka kërkuar nga Kryetarja e gjykatës afat shtesë edhe për 30 ditë për përpilim të aktgjykimit të cilën kërkesë e ka aprovuar Kryetarja e gjykatës me Aktvendimin me numër GJA.nr.406/2024 të datës 22.04.2024.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart, në kuptim të nenit 363, par. 1, nën par. 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr. 518/14, datë 23.05.2024

Bashkëpunëtore profesionale
Valbone Musa Lajçi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Avni Syla

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 30 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.